

20151544454

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE
INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15 dhe 147/15), në nenin 100 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni në stazh të sigurimit konsiderohet edhe koha e të siguruarit që e ka kaluar në marrëdhënie pune ose vetëpunësim si zëvendësim për punëtor i cili ka shfrytëzuar pushimin e lehonisë nga puna për periudhën deri sa zgjat pushimi lehonisë, për çka është konstatuar çlirim nga pagimi i kontributeve të sigurimit të detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë."

Neni 2

Në nenin 118 në paragrafin (5) fjalët "paragrafi (3)" zëvendësohen me fjalët "paragrafët (3) dhe (4)".

Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".